

**KESHILLI I BASHKISE I QYTETIT TE KORCES**

**VENDIM**

NR 48 DATE 19.07.07

**PER NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK Nr 92 DATË 27.12.2006 "PËR PERCAKTIMIN E PRIORITETEVE TE INVESTIMEVE PER VITIN 2007"**

Keshilli i Bashkise Korce, ne mbledhjen e tij te dates se sotme , pasi mori ne analize relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Puneve Publike dhe Drejtoria e Finances PER NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK Nr 92 DATË 27.12.2006 "PËR PERCAKTIMIN E PRIORITETEVE TE INVESTIMEVE PER VITIN 2007", mbeshtetur ne ligjin nr. 8652 date 31.07.2000 " Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore " neni 32, germa "dh", neni nr.10 dhe neni nr.72 ne ligjin nr. 8399 date 09.09.1998 " Per buxhetin lokal ", ne Ligjin nr 9645 dt. 27.11.2006 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007" Udhëzim nr 2 dt. 17.01.2007 i M.F. "Për zbatimin e buxhetit të shtetit per vitin 2007." Udhezimi Nr.353 date 19.03.2007 i Ministrisë së Brendshme "Për zbatimin e buxhetit te qeverisjes vendore per vitin 2007". ne kompetencat qe ka si dhe mbas diskutimit te anetareve

**VENDOSI**

1. Të Miratojë ndryshimin e prioritetit nga Sistemim-Asfaltim rruga "1 Maji" me vlere 17 111 900 lek në Sistemim-Asfaltim, Trotuarë dhe Lulishte Rruga "1 Maji" dhe Bllok Banimi Lagj. Nr 9 me vlere 38 833 316 Lek.
2. Të miratojë si prioritet objektin: Rikonstruksion i fushës të Futbollit stadiumi "Skënderbeu" me vlerë 11 259 589 lek
3. Të miratojë si prioritet objektin: Punime plotësuese për fushën stërvitore Nr. 1 me vlerë 5 982 240 Lek.
4. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohen Drejtoria e Puneve Publike. Drejtoria e Urbanistikes dhe Drejtoria e Finances.
5. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

**KRYETARI**

**Rajmonda Nase**